Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës Nr.8 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të çertifikuar nga organet tatimore. *(nëse nuk është çertifikuar bilanci i Vitit 2020, të dorëzohen bilancet gjatë viteve 2018 dhe 2019)*
2. Xhiroja vjetore mesatare e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2020 *(ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar)*, duke paraqitur një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shënohen datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të mallrave ose vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës të shoqëruar me faturat tatimore të shitjes ku të shprehen qartë datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të mallrave. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore të shitjes, (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat).

2.3. Kapaciteti teknik:

- a) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (*nr.1 deri në nr.47 sipas tabelës në Shtojcën Nr.9*), duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it. Katalogu/fragmentet e katalogut ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse paraqiten fragmente katalogu, ato duhet të përmbajnë informacion se kujt katalogu i përkasin dhe të dhëna për publikuesin e tij.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat e ofruara, sipas përcaktimeve në Shtojcën Nr.9 Specifikimet Teknike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Specifikime teknike
1	CD	Këto CD duhet të mbajnë deri në 700 Mb ose jo më pak se 80 minuta regjistrim. Diametri i diskut optik 120mm. Shpejtësia e shkrimit të diskut deri në 52x. Në paketim jo më shumë se 10 copë ku secili të ketë kutinë (kapakun) e tij. Të jenë të rishkrueshëm dhe të printueshëm.
2	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	Kjo dosje të jetë prej kartoni të presuar dhe të plastifikuar dhe shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat tuaja të rëndësishme. Ajo mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për t'u lëvizur lehtësisht. Me llastik të gjerë. Përmasat 33±1cm x 25±1cm x 6cm. Me trashësi të kartonit jo më pak se 500gm ² .
3	Dosje arkive me mekanizëm	Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 32.5 ± 1cm x 29.5 ± 1cm x 8 cm. Materiali te jete polipropilen dhe karton i presuar i plastifikuar. Të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 700 fletë me gramaturë 80gm ² . Të ketë minimumi 2 vjet garanci për mekanizmin.

Dokumentat Standarde të Tenderit

4	Dosje me llastik	Kjo dosje të jetë prej kartoni të presuar dhe të plastifikuar me shkëlqim dhe shërben për të mbrojtur dhe ruajtur dokumentat. Mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për t'u lëvizur lehtësisht. Me 3 lembe dhe me llastik të gjerë. Përmasat $33\pm 1\text{cm} \times 25\pm 1\text{cm}$. Të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 250 fletë A4 me gramature 80gm^2 .
5	Dosje me llastik (thellësi 4cm)	Kjo dosje të jetë prej kartoni të plastifikuar shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat tuaja të rëndësishme. Ajo mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për tu lëvizur lehtësisht. Me 3 lembe. Me llastik të gjere. Përmasat $33\pm 1\text{cm} \times 25\pm 1\text{cm} \times 4\text{cm}$. Trashësia e kartonit të jetë minimumi 500gm^2 .
6	Dosje arkive me lidhëse	Dosje prej kartoni me lidhëse me tre lembe me gjerësi 15cm. Kjo lloj dosje është e përdorshme për institucionet shtetërore, depot e ndryshme, të cilat kanë vëllime të madh të dokumentave arkivuese. Kjo lloj dosje me lidhëse lejon të ruhen sa më shumë vëllim dokumentash të jetë e mundur.
7	Dosje Arkive me buton	Dosje me buton 15cm, polipropileni. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet tuaja të rëndësishme. Gjithashtu, ajo ka një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat $36\text{cm}\pm 1\text{cm} \times 26\text{cm} \pm 1\text{cm} \times 15\text{cm}$.
8	Qese plastike A4	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A4, me spesor jo më pak se 120 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësve të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese të ketë kapacitet jo më pak se 30 fletë A4 80gm^2 secila.
9	Kapak plastik transparent A4	Kapak polipropileni transparent A4 me trashësi jo më pak se 250 mikron. Paketimi në pako deri në 100 copë. Material anti gërvishtje.
10	Kapak kartoni A4	Kapak kartoni A4 me masë $250\text{g}/\text{m}^2$ - $300\text{g}/\text{m}^2$ me ngjyra të ndryshme. Paketimi në pako deri në 100 copë.

Dokumentat Standarde të Tenderit

11	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash 12-16 sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
12	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 10mm	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 10mm
13	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 14mm	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 14mm
14	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 25mm	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 25mm
15	Makinë kapse aktesh standart (Stapler)	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 40 fletë të gramaturës 80 gr/m ² . Të përdoret me gjysëm force. Të përdoret me tela/kapëse 24/6, 26/6 dhe 24/8. Të ketë garanci jo më pak se 1 vit.
16	Makinë kapse aktesh e madhe (23/8-23/24)	Makinë kapëse aktesh prej materiali metalik. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 200 fletë të gramaturës 80 gr/m ² . Gjithashtu ajo duhet të kapi dhe me pak fleta në varësi të përdorimit duke ndërruar numrin e telave. Të ketë sistem antiblokuës për përdorim sa më të thjeshtë. Të ketë depozitë për të vendosur telat. Çdo informacion shtesë për numrin e telave që përdoren në varësi të fletave duhet të jenë të shpjeguara dhe në trup të produktit. Të ketë garanci jo më pak se 1 vit.
17	Tela/kapëse 24/6	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Të kapi deri në jo më pak se 30 fletë të gramaturës 80gr/m ² . Paketimi 1000 copë.
18	Tela/kapëse 23/10	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Te kapi deri ne jo me pak se 70 flete te gramatures 80gr/m ² . Paketimi 1000 copë.
19	Tela/kapëse 23/13	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Paketimi 1000 copë.

Dokumentat Standarde të Tenderit

20	Tela/kapëse 23/20	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Paketimi 1000 copë.
21	Portamina 0.7mm	Të jetë e ndërtuar me trup metalik i ndërtuar me anë të sistemit të ushqimit të majave që lejon shkrimin pa ndërprerje me mina 0.7mm HB.
22	Mina 0.7mm	Mina 0.7mm HB. Gjatësia e minave 6cm. Paketimi të ketë jo më pak se 40 copë.
23	Mprehëse lapsash	Mprehës lapsash me dy vrima dhe me depozitë për ashklat e mprehura. Për lapsa deri në Ø10 mm dhe kënd mprehës prej 30°. Thikat e mprehjes të jenë metalike të kromuara ose metal i pandryshkshëm.
24	Makinë për të hapur vrimat në dokumenta për dosjet me mekanizma	Hapësi i vrimave të letrës të jetë i bërë nga materiali metalik, që përdoret për të hapur vrima dopjo në letër A5-A3 deri në 65 letra njëherësh. Të jetë i pajisur me distanciator për të zgjedhur llojin e letrës që do të hapen dopjo vrimat. Me sistem anti bllokues për letrën.
25	Kapëse me vesh 25mm	Ndërtimi i produktit të jetë prej metali të fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi 12 copë.
26	Kapëse me vesh 32 mm	Ndërtimi i produktit të jetë prej metali të fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi 12 copë.
27	Kapëse me vesh mm 41mm	Ndërtimi i produktit të jetë prej metali të fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi 12 copë.
28	Kapëse me vesh 51 mm	Ndërtimi i produktit të jetë prej metali të fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi 12 copë.
29	Korrektor stilolaps	Korrektor në formë stilolapsi që shërben për korrigjimin e gabimeve të bëra gjatë shkrimit. Siguron mbulim të mirë dhe thahet shpejt duke lënë një shtresë të butë mbi të cilën mund të shkruhet sërish.

Dokumentat Standarde të Tenderit

30	Kapëse "U" 28mm	Kapëse prej teli dokumentash, 28 mm. Të jetë ideale për të kapur letra apo dokumente të ndryshme në zyrë, shkollë etj. Të jetë e ndërtuar me material çeliku të qëndrueshëm. Paketimi në pako me 100 copë kapëse.
31	Stilolaps roller blu	Stilolaps i tipit roller me majë 07mm-0.8mm dhe me linjë 0.4mm-0.6mm. Të jetë me bojë të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë rrjedhje. Jetëgjatësia e bojës të jetë deri në jo më pak se 2000m. Paketimi në pako deri në 30 copë.
32	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Jetëgjatësia e bojës të jetë deri në jo më pak se 1500m. Paketimi në pako deri në 30 copë.
33	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike i kuq	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Jetëgjatësia e bojës të jetë deri në jo më pak se 1500m. Paketimi në pako deri në 30 copë.
34	Tampon vule blu	Tampon vule i mesëm me kuti metalike. Përmasat 80mm ± 10mm x 150mm ± 10mm.
35	Bojë vule blu	Bojë ngjyrë blu për të gjitha llojet e vulave. Bojë e pastër mjedisore dhe shumë rezistente. Paketimi në shishe plastike 25ml-30ml.
36	Goma për fshirje lapsi	Gomë universale për fshirje lapsi dhe boje. Të jetë e bërë nga materiali gome e bute (jo PVC), e përshtatshme për të fshirë dhe njollat me të theksuara të lapsit dhe bojës. Nuk duhet të lerë shenja dhe grimca në fletë pas përdorimit. Peshë 10g-15g.
37	Lapsa HB	Lapsi prej grafiti të jetë i prodhuar nga materiale sintetike, që do të thotë se nuk lëshon cifla në rast se thyhet, si dhe të jetë rezistent ndaj shtypjes dhe përdorimit. Shkalla e grafitit të jetë HB.
38	Evidenciator (highlighter)	Evidenciatori të ketë një majë në formë dalte të petëzuar e cila ndihmon për nënvijëzime ose evidentime, si dhe të jetë i gomuar për më shumë komfort dhe kontroll. Të ketë ngjyrë shumë të ndezur të verdhë ose portokalli, e cila thahet menjëherë dhe nuk është toksike. Maja e vijëzimit të fillojë nga 2mm më e holla deri në 5mm më e trasha.
39	Stick ngjitës	Ngjitësi nuk duhet të jetë toksik dhe nuk duhet të përmbajë acid duke shmangur kështu dëmtimin e materialeve në të cilat përdoret. Paketimi 70g-100g në formë cilindri roller.

Dokumentat Standarde të Tenderit

40	Mbajtëse kancelarie	Mbajtëse kancelarie me set bazik të përfshirë. Në këtë set përfshihen: mbajtësja e rrotullueshme e kancelarive, laps, stilolaps, gërsërë, vizore, prefëse lapsi, kapse letrash etj. Mbajtësja të jetë prej materiali plastik. Preferohet ngjyrë e errët.
41	Mbajtëse dokumentash metalike me 3 kate	Mbajtëse dokumentash metalike 3 kate, ngjyrë e zezë, me përmasa 36±1cm x 28±1cm x 30±1cm. Ajo shërben për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe është e përshtatshme për zyra. Të jetë tërësisht metalike dhe shumë e qëndrueshme.
42	Heqëse telash stapleri	Heqëse telash stapleri e përbërë me material metalik dhe me një pjesë plastike. Të heqë të gjitha llojet e telave standarte. Të jetë i përshtatshëm për përdorim zyre. Të ketë një mekanizëm të ndërtuar në menyrë të tillë që të eliminojë çdo dëmtim që mund të shkaktojë tek përdoruesi gjatë procesit të heqjes së telave.
43	Blllok letrash me ngjitje	Bllloqe me ngjitje 75mm±1mm x 75mm±1mm me 50 fletë me ngjyra të ndryshme. Letrat ngjitëse shërbejnë për të nxjerrë në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të vështira. Ato mund të përdoren për të shënuar lajmërime,shënime etj.
44	Makine llogaritëse	Makinë llogaritëse tavoline me jo më pak se 12 shifra të shfaqura në ekran. Të ketë ekran të madh me pjerrësi të rregullueshme. Të ketë burim energjie me bateri pa zhivë. Zgjedhje rumbullakimi dhe presje dhjetore. Të ketë opsionin fikje automatike nëse nuk përdoret.
45	Vizore 30 cm	Vizore me gjatësi 30 cm prej materiali plastike transparente dhe rezistente që nuk thyhet. Të ketë dizajn tërheqës, sipërfaqe ergonomike që lejon përdorim dhe fiksimit të lehtë në sipërfaqe, shënuesit me cilësi të lartë me ngjyra rezistente ndaj rrezatimit UV për qëndrueshmëri optimale.
46	Ndarëse kartoni për dosje me 12 ngjyra	Ndarëset me ngjyra të ndryshme që thjeshtojnë arkivimin dhe kategorizimin e dokumentave. Të jenë me ngjitje në njërin anë dhe të përshtatshme për dosje A4.
47	Blllok shënimesh (Note book)	Blllok shënimesh me kapak të fortë (hard cover) dhe me jo më pak se 100 fletë. Në format shkrimi me ndarje horizontale të barabarta. Përmasat 22cm ±2cm x 16cm±2cm.

Dokumentat Standarde të Tenderit

48	Libër Protokolli (400 fletë) [35cmx25cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
49	Blllok Fletë-Dalje (50 fletë x 3 kopje) [18cmx14cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
50	Libër i Bibliotekës (100 fletë) [35cm x 25cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
51	Blllok Fletë-Hyrje (50 fletë x 3 kopje) [18cmx14cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
52	Blllok Urdhër-Dorëzimi (50 fletë x 2 kopje) [15cmx20cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
53	Blllok Kërkese (50 fletë x 2 kopje) [15cmx20cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
54	Libër inventari për shkollat (150 fletë) [28cmx20cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
55	Libër inventari për punonjësit (50 fletë) [28cmx20cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
56	Blllok procesverbali kalim inventari (50 fletë x 3kopje) [21cmx30cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
57	Blllok procesverbali vlerësimi (50 fletë x 3kopje) [21cmx30cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
58	Karta identifikuese punonjësi	Karta identifikuese duhet të jetë prej kartoni të fortë me masë jo më pak se 300g/m ² , me përmasa 9cmx6cm dhe të jetë e pajisur me mbajtëse të plastifikuar dhe rrip me gjerësi 1.5cm-2cm dhe perimetër 80cm-90cm ngjyrë portokalli/kuqe për vendosje rreth qafës me logon Bashkia Tiranë. Rripi me mbajtësen e plastifikuar të lidhen me njëra-tjetrën me mekanizëm metalik me hapje me manuale dhe mbyllje automatike. Përmbajtja e kartave do jetë e printuar me ngjyra nga të dyja anët dhe do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Produktet për të cilat kërkohet garanci, gjatë lëvrimit të mallit duhet të shoqërohen me fletë garancie sipas përcaktimeve në Shtojcën Nr.9 Specifikimet teknike.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	CD	copë	100
2	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	copë	100
3	Dosje arkive me mekanizëm	copë	400
4	Dosje me llastik	copë	700
5	Dosje me llastik (thellësi 4cm)	copë	200
6	Dosje arkive me lidhëse	copë	200
7	Dosje Arkive me buton	copë	200
8	Qese plastike A4	pako	100
9	Kapak plastik transparent A4	copë	500
10	Kapak kartoni A4	copë	500
11	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash	copë	500
12	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 10mm	copë	100
13	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 14mm	copë	100
14	Spirale plastike për makinë libër-lidhje 25mm	copë	100
15	Makinë kapse aktesh standart (Stapler)	copë	30
16	Makinë kapse aktesh e madhe (23/8-23/24)	copë	5
17	Tela/kapëse 24/6	pako	400
18	Tela/kapëse 23/10	pako	30
19	Tela/kapëse 23/13	pako	20
20	Tela/kapëse 23/20	pako	20
21	Portamina 0.7mm	copë	100
22	Mina 0.7mm	pako	200
23	Mprehëse lapsash	copë	50

Dokumentat Standarde të Tenderit

24	Makinë për të hapur vrimat në dokumenta për dosjet me mekanizma	copë	30
25	Kapëse me vesh 25mm	pako	200
26	Kapëse me vesh 32 mm	pako	100
27	Kapëse me vesh mm 41mm	pako	100
28	Kapëse me vesh 51 mm	pako	50
29	Korrektor stilolaps	copë	100
30	Kapëse "U" 28mm	pako	500
31	Stilolaps roller blu	copë	200
32	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	copë	800
33	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike i kuq	copë	100
34	Tampon vule blu	copë	5
35	Bojë vule blu	copë	5
36	Goma për fshirje lapsi	copë	50
37	Lapsa HB	copë	50
38	Evidenciator (highlighter)	copë	100
39	Stick ngjitës	copë	100
40	Mbajtëse kancelarie	copë	30
41	Mbajtëse dokumentash metalike me 3 kate	copë	20
42	Heqëse telash stapleri	copë	50
43	Bllok letrash me ngjitje	copë	500
44	Makine llogaritëse	copë	20
45	Vizore 30 cm	copë	30
46	Ndarëse kartoni për dosje me 12 ngjyra	pako	200
47	Bllok shënimesh (Note book)	copë	100
48	Libër Protokolli (400 fletë) [35cmx25cm]	copë	5
49	Bllok Fletë-Dalje (50 fletë x 3 kopje) [18cmx14cm]	copë	400
50	Libër i Bibliotekës (100 fletë) [35cm x 25cm]	copë	50
51	Bllok Fletë-Hyrje (50 fletë x 3 kopje) [18cmx14cm]	copë	20
52	Bllok Urdhër-Dorëzimi (50 fletë x 2 kopje) [15cmx20cm]	copë	30

Dokumentat Standarde të Tenderit

53	Bllok Kërkese (50 fletë x 2 kopje) [15cmx20cm]	copë	30
54	Libër inventari për shkollat (150 fletë) [28cmx20cm]	copë	100
55	Libër inventari për punonjësit (50 fletë) [28cmx20cm]	copë	500
56	Bllok procesverbali kalim inventari (50 fletë x 3kopje) [21cmx30cm]	copë	20
57	Bllok procesverbali vlerësimi (50 fletë x 3kopje) [21cmx30cm]	copë	20
58	Karta identifikuese punonjësi	copë	900

Afatet e lëvrimnit:

Deri më 10 (dhjetë) ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës në vendodhjen e përcaktuar në DST sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në kohë dhe sasi.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
